



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – Dëgjimi buxhetor me OJQ, shoqëri civile dhe klube sportive.

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Salla e Kuvendit Komunal në Pejë

Takimi ka filluar në ora: 12:00

Datë: 04.08.2025

Sot, në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, në ora 12:00 është mbajtur dëgjimi publik me OJQ, shoqëri civile dhe klube sportive.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Nënkryetari për Komunitete në Komunën e Pejës, z.Mirzet Džogović, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha, Drejtorë të ekzekutivit, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe Ju uroj mirëseardhje në dëgjimin publik për projektimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Thirrja për këtë takim ka qenë, që duke respektuar strategjinë, që e ka Komuna për transparencë dhe bashkëpunimin me qytetarë dhe gjithëpërfshirjen e qytetarëve në projektimin e buxhetit do ta keni mundësinë, që këtu bashkë t'i shqyrtojmë çështjet e ndryshme, që janë në interes nga shoqëria civile dhe qytetarët.

Fjalën, po e kaloj te Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha, e cila do t'i jap referencat kryesore të projektit të buxhetit dhe pastaj ka hapësirë, që secili nga Ju t'i parashtrojë kërkesat e veta.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e buxheti i ndarë për vitin 2026 është 41,953,838.00, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe medijtje: 21,096,340.38;

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00;

Shpenzime komunale: 1,107,240.00;

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00, ku kemi një rritje prej 10% krahasuar me vitin e kaluar dhe Shpenzime kapitale: 12,938,317.62.

Duhet të theksojmë se në fazën në të cilën jemi duke folur mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsye se ende nuk e kemi pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, nga Ministria e Financave, prandaj këto kategori mund të ndryshojnë pas pranimit të Qarkores së Dytë Buxhetore, pra kategoritë e buxhetit nuk janë fikse.

Takimet për dëgjimet buxhetore do të vazhdojnë dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat e qytetarëve.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Rina Berisha – Kryetare e Klubit "Peja 03" të nderuar të pranishëm klubi, të cilin e përfaqësoj unë është klubi, i cili nuk ka ardhë shumë moti në Pejë edhe kemi sjellë risi për këto tri vite sa jemi në superligën e Kosovës, të cilat janë vënë në pasqyrim edhe te Federata e Kosovës tash jemi ekipi i vetëm, që e përfaqësojmë Kosovën në garat evropiane, përveç kësaj jemi përfaqësues të vetëm të Pejës edhe në ligën unike.

Ne e kemi marr një mbështetje goxha të mirë sa i përket Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe kemi pas mbështetje nga Drejtoresha e Administratës. Arsyeja, që kam ardhur sot këtu dhe po e parashtrojmë këtë kërkesë është se shpenzimet tona janë shumë më të mëdha se ajo, që komuna mundet me na ofru. Unë këtë vit kam kërkesë specifike, që këtë vit me pas ma shumë rëndësi, që vitin e ardhshëm me pas një përkrahje pak më të madhe prej komunës. Ju faleminderit!

2. Fitore Cena – Haxhihasani - përshëndetje për të gjithë unë si përfaqësuese e organizatave, që ofrojnë shërbime në nivel komune një lajm i mirë për rritjen e subvencioneve dhe shpresojmë, që ky subvencionim, prej 10 % të jetë për çdo organizatë për vitin e ardhshëm dhe të rriten edhe më shumë se me të vërtetë shërbimet ka nevojë t'i ketë qyteti, sepse donatorët çdo ditë e më pak po janë. Pasi ka rritje të buxhetit "Qendra për Jetë të Pavarur" a do të ndërtohet objekti i ri apo jo?

3. Ardita Bala nga "Qendra për Mirëqenien e Gruas" na çdo vit kemi rritje të subvencioneve, por kisha dasht me fol për dy shërbime, të cilat i ofron Peja, por na kanë ndodhur disa raste kur gratë tona kanë pas nevojë për çerdhe edhe na i kanë refuzu fëmijët dhe duke i ditë vështirësitë, që ato janë nëna vetushqyese mezi presin me të ardhurat e tyre me pagu qiranë e lëre ma me pagu çerdhe private me pas një mundësi se nuk është numri i madh edhe me rrit pak edhe shumën për pagesën e qirasë.

4. Gentonisa Avdyli jam Nënkryetare e Asamblesë Komunale të Fëmijëve ne si Kryesi e Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Pejë e kemi pa të arsyeshme me dhanë kontributin tonë në planifikimin e buxhetit 2026 të Asamblesë Komunale të Fëmijëve për përmirësimin e kushteve në shkollë, sepse disa nevoja, që i kemi në shkollë janë higjiena e veçanërisht në toaleta, banka të reja dhe të përshtatshme për nxënësit, rrethoja mbrojtëse për shkollë, shëtitore me ushqim të shëndetshëm, mirëmbajtje të trotuareve, pranë shkollave, siguri në objektet e shkollave etj.

5. Klementina Kelmendi nga organizata "Syri i Vizionit", unë kam ardhë me disa kërkesa të takimeve të përbashkëta, që kemi pas për urën e gjelbër kanë ardhë disa kërkesa nga KDI dhe qytetarët, një ndër to është rrethimi i kontinierëve të mbeturinave në fshatin Kuçishtë dhe e kanë marr shembull fshatin Shtupeq, vendet me mbeturina të pastrohen. Po ashtu, kemi kërkesë nga qytetarët në financimin e një fushate stimuluese, ku stimulohet raportimi i qytetarëve dhe të shpërblehen për raportimet e tyre.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Kryesuesi takimin e mbylli në ora 13:00.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ













**LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË DEGJIME BUXHETORE PËR
2026, OJQ, SHOQERIA CIVILE, KLUBET SPORTIVE**

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Data: 04.08.2025

Ora: 12:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	Erina Beckha	KBF PEJA 03	
2	Lion Basha	KBF PEJA 03	
3	SHKELCIM GASHI	KF RIZIJA 1974	
4	Blendona Abazi	QKD-PEMA	
5	Xhemile Dajçi	QKD-PEMA	
6	RROW AJDINI	YALEC-PEJA	
7	Albina Krasnigi	KVRL	
8	Gentonisa Ardyli	AKF	
9	Ima Begolli	AKF	
10	Lirika Dlugku	SCIK	
11	Arleta Baku	QMG	
12	Klementina Kelmadi	SiV	
13	Teta Vka	SiV	
14	Varia Etushi	ASOP	
15	SANICA DRANGOLI	K.K. PEJE	
16	Fitore Haxhihasani	OJQ, Q.J.P"	
17	Albert Husaj	Sporti shkollor	

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	Voldet Sheshi	K.F. PEJA-CIT	
19	EROLL GRAPCI	SH.P.S.R., TROJTA PEJE	
20	Sabina Mehmedovic	OSCE	
21	Kostriot Belegu	Komuna e Pejes	
22	Vullnet Jusir	Komuna e Pejes	
23	Jamir Haparij	Komuna e Pejes	
24	SHIPRISA LUKAB	U.D. DROTHCO	
25	GAZEMO TURKU	K.K. PEJE	
26	Fatmir Tugan	K.K. PEJE	
27	HABRIG HAXHIM	K.K. PEJE	
28	XHENET SYKA	DKRS	
29	Diellza Beusha	K.K. PEJE	
30	GAZEMO MUHAXHER	K.K. PEJE	
31	ALBULENA MOJAT SARAJEVARAJ D.M.S	D.M.S	
32	Mir Pandun	K.K. PEJE	
33	REKHEP KURIBON	K.K. PEJE	
34	FATMIK ARCANI	K. PEJE	
35	Urosh Gega	K.K. PEJE	
36	Duke Krenjic	K.K. PEJE	
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			
49			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – ME BASHKËSITË LOKALE TË QYTETIT

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Salla e Kuvendit Komunal në Pejë

Takimi ka filluar në ora: 16:00

Datë: 04.08.2025

Në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, në ora 16:00 është mbajtur dëgjimi publik me të gjitha Bashkësitë Lokale të qytetit.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin e ardhshëm.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe ju uroi mirëseardhje në dëgjimin publik për projektimin e buxhetit për vitin e ardhshëm.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha, Drejtorë të ekzekutivit, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Fjalën, po e kaloj te Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha, e cila do t'i jep referencat kryesore të projektit të buxhetit dhe pastaj ka hapësirë, që secili nga Ju t'i parashtojë kërkesat e veta.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e buxheti i ndarë për vitin 2026 është 41,953,838.00, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe medijtje: 21,096,340.38;

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00;

Shpenzime komunale: 1,107,240.00;

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00, ku kemi një rritje prej 10% krahasuar me vitin e kaluar dhe Shpenzime kapitale: 12,938,317.62.

Duhet të theksojmë s'e në fazën në të cilën jemi duke folur mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsye s'e ende nuk e kemi pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, nga Ministria e Financave, prandaj këto kategori mund të ndryshojnë pas pranimit të Qarkores së Dytë Buxhetore, pra kategoritë e buxhetit nuk janë fikse.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Kadri Mavraj nga "7 Shtatori", po ju përshëndes të gjithëve unë adresimin e kërkesave e kam bërë në shkurt dhe e kam vazhduar deri në maj me shumë kërkesa, buxheti i komunës dhe vërejtjet në tendera kanë mbet disa punime të pakryera e domosdoshme kish me qenë trotuari në rrugën "Konferenca e Bujanit", prej furrës "Husaj" e deri te rruga "Agim Binak Çelaj", trotuari me rrethoja është i

nevojshëm, ndërsa në rrugën "Myrvete Maksutaj" ku ka ngel kubëzimi duhet me vazhdu, si dhe mirëmbajtjen dhe ndriçimin e kemi problem.

2.Mazllum Hyseni jam nga pjesa mbi ujësjellës nuk kemi zgjerim të rrugës, nuk kemi rryme e as ujë, as ndriçim të rrugës, jemi goxha shumë banorë dhe askush s'po merret me ne.

3.Alfrid Uka – përshëndetje për të gjithë unë jetoj në fillim të lagjes "Kristal" e kam vetëm një kërkesë, që të parashihet një trotuar për fëmijë të asaj lagjes rruga kryesore është "Qerim Muriqi", që lidhet me rrugën "Jeton Dedushaj".

4.Sadri Uka nga bashkësia lokale "Kristali" dhe fshati Leshan për lagjen "Kristal" e kam fjalën për rrugën "Azem Lukaj", "7 Shtatori" është ndërtu në 2005 dhe aty është punu edhe njëherë dhe ujërat e zeza janë në anën e djathtë, si dhe nuk ka vend për trotuar, ndërsa dritat janë të ndezura dhe shpenzojnë shumë, ndërsa në Leshan dhe Kliqinë është një vend, ku një rrugë "Hysen Berisha" është vazhdu deri në një vend, përkatësisht deri te një pronë e caktuar dhe të hapet ajo rrugë dhe të lidhet me rrugën kryesore Pejë-Prishtinë.

5.Shpend Salihaj – përshëndetje për të gjithë së pari më lejoni t'ju falënderoj për një punë, që e keni përfundu në lagjen time, kisha kërku, që edhe një kërkesë të më plotësohet e rëndësishë së veçantë është rruga kryesore, që lidhet me Tranzit, pra rruga "Adrian Krasniqi" të bëhet shtrimi i trotuareve , korrigjimi i shtyllave të ndriçimit sepse ka shumë nxënës, si dhe po rrezikohen qytetarët.

6. Valbona Avdiu – Kryetare e Bashkësisë Lokale "2 Korriku", po du me ju falënderu për të gjitha punët e mira, që janë bë në lagjen tonë, ka mbet vetëm kanali, që pritet me fillu edhe punët aty ne emër të banorëve jemi shumë falënderues, po është me rëndësi të theksojmë se sedimentuesi, që është bërë sidomos në ditët me shi është kërkesë e banorëve, që të pastrohet aty, si dhe kërkesat për disa rrugica të vogla a do të mund të hyjnë në buxhet, për ndriçim është në rregull, si dhe është një mur i dëmtum, që i ndan rrugët dhe është e nevojshme të largohet. Po ashtu çdo natë po kemi hajni për shkak të ndriçimit, që po ndalet në ora një, janë dhjetë shtëpi, që janë thy.

7. Agim Nikqi – përshëndetje për të gjithë a ka mundësi nëpër lagje me na vendos kamera se po ka shumë hajna, ndërsa policia janë lajmëru, si dhe kemi nevojë për disa policë të shtrirë te stacioni i autobusëve, si dhe një kërkesë për një sallë të sporteve. Të gjitha kërkesat i kam dorëzu.

8. Ukë Lajçi – përshëndetje për të gjithë jam nga lagjja "Dardania 2", trotuari, prej Arbërit për mu bashku me "Dardaninë 3", sepse fëmijët janë në shkollë, si dhe në lagjen ku shumica janë komunitete mungojnë dritat, kanalizimi, asfalti, ndërsa në disa rrugë kanë vendosur zall.

9. Bejhan Krasniqi – Kryetar i Këshillit Lokal "Karagaç", rruga "Vëllezërit Gjokaj", një pjesë është bërë asfalt, ndërsa një pjesë ka mbetë?

Kryetari i Komunës së Pejës, z. Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Takimet për dëgjimet buxhetore do të vazhdojnë dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat e qytetarëve

Kryesuesi takimin e mbylli në ora 17:30.

Procesmbajtësja:

Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË DEGJIME BUXHETORE PËR
2026, OJQ, SHOQËRIA CIVILE, KLUBET SPORTIVE









QITETI TË GJITHA QASIMSGJITE COPAZG

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Data: 04.08.2025

Ora: ~~12:00~~ 16:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	KADRI MAVRAJ	B.L. 7 shkurti	
2	Nexhat Miroci	B.T. "XH. KADA"	
3	Saolir Uka	Ac. "Azem Lushaj"	
4	BEJHAX KRASHIĆ	K-B-L-KARAGAJ	
5	VALBON AURIJAJ	K.L. 2 KORRIKU	
6	FISHIK BERISHA	B.L. DARDANIA 3	
7	SHPENI SALIHAD	K.L. DARDANIA 1	
8	AGIM NIKRI	K.L. PROKAZIĆI	
9	LUAN PAVATA	SAJAT KUVA	
10	ALFON UKA	LEVOSHE - PËR	
11	MIZELOR HYSËLI	LEVOSHE PËR	
12	JAKUP LAJCI	DARDANIA II	
13	SHPESA LUKA	U.D. DRESTOCQ a.r.s.	
14	Sabina Mehmedovic	OSCE	
15	Kostinot Deleq	Komuna e Pejës	
16	Agonis Thapi	Komuna e Pejës	
17	ERZEND TURKU	KOMUNA E PEJËS	

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	FATMIR, PATI	K.K. PEJE	
19	DEJTA REASNI	K.R. PEJE	
20	NOSET GEGOI	K.K. PEJE	
21	NTA PANDANI	K.K. PEJE	
22	AZULENA MUJAJ BAJEKUPAJ	D.M.S	
23	EDONETA BENISTA	K.K. PEJE	
24	GËZIM GASHI	K.R. PEJE	
25	DIELLEA BOGUSHI	K.K. PEJE	
26	ARIMUT KAMQIPI	K.K. PEJE	
27	REXHEP KURIBOGAI	K.K. PEJE	
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			
49			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – ME BANORËT E FSHATRAVE TË RUGOVËS

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Kuvendi Komunal në Pejë

Takimi ka filluar në ora: 18:00

Datë: 04.08.2026

Në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, në ora 18:00 është mbajtur dëgjimi publik me fshatrat e Rugovës.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin e ardhshëm.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe ju uroi mirëseardhje në dëgjimin publik për projektimin e buxhetit për vitin e ardhshëm.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha, Drejtorë të ekzekutivit, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e buxheti i ndarë për vitin 2026 është 41,953,838.00, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe medijtje: 21,096,340.38;

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00;

Shpenzime komunale: 1,107,240.00;

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00, ku kemi një rritje prej 10% krahasuar me vitin e kaluar dhe Shpenzime kapitale: 12,938,317.62.

Duhet të theksojmë se në fazën në të cilën jemi duke folur mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsye se ende nuk e kemi pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, nga Ministria e Financave, prandaj këto kategori mund të ndryshojnë pas pranimit të Qarkores së Dytë Buxhetore, pra kategoritë e buxhetit nuk janë fikse.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Agim Haxhiaj – Sot do të flasë në emër të familjes Haxhiaj dua t'i bëj disa kërkesa, që presin me vite me radhë, por para se t'i bëj kërkesat dua t'ju falënderoj për punën, që është bërë në vitin e kaluar. Kam dy kërkesa janë 1300 metra rrugë, që janë anekse rrugore nga villat "Fama", "Haxhijaha", "Bujtina e Gjyshes", si dhe aneksi të vazhdojë për 500 metra, kanalin e shirave, si dhe ndriçimin publik.

2.Demë Salihaj -Përfaqesues i fshatit Kuçishtë i kam disa kërkesa, asfaltimi i rrugës lidhëse, që lidhet me trasen Kuçishtë-Bogë, me gjatësi 1700 metra, na e bën të qasshme rrugën në pronat tona, traseja e rrugës, prej rrugës kryesore me dal te kisha, disa bazena të ujit, por tokat më të rëndësishme i kemi pa qasje rrugore.

3.Ramiz Qorraj - Fshati Drelaj e kemi një projekt për një ujësjellës në Liqenat, që e kemi dorëzuar para pesë viteve dhe është i nevojshëm sepse kemi ujë të mjaftueshëm i kemi

edhe dy vendbanime një segment afër 3 km rrugë dhe një rrugë të pjesa e Shalës 1 km e 600 metra.

4.Ramë Budima - Jam i interesuar për një rrugë në fshatin Stankaj janë 20 ose 30 shtëpi.

5.Driton Mujaj -Nga fshati Dukaivë kam një kërkesë të lagjja e "Mujajve" për një rrugë deri në 2 km.

6.Armend Lajçi – Rrugën, që e përmendi më herët Drejtori Ramiz Qorraj është rruga 980 metra.

7.Xhevat Osmanaj - Para dy viteve e kemi bërë një paramasë dhe një parallogari për një rezervuar në lagjen "Gjevukaj" e kam dorëzuar në drejtorat dhe ju jeni në dijeni të gjithë.

8.Isuf Lajçi - Po mendoj, që ka ardhë koha me intervenu në fshatin Shtupeq i Vogël dhe kemi vendos me kërku asfaltim të rrugës deri ku keni mundësi të paktën të kemi qasje, e kemi një projekt për ujë, që dy vite po ju lutem të na ndihmoni, që të kemi leje nga Ministria e Planifikimit Hapësinor.

9.Flamur Rexhbogaj - Unë i kam dy kërkesa të vogla nëse ka mundësi e para është për fshatin Bogë ka ngec bazeni i ujit, që ka pa fillu të ndërtohet dhe të vazhdohet rruga dhe të lidhet me rrugën kryesore kanë mbet rreth 300 – 400 metra, nëse ka mundësi se i lidhin dhjetë familje, si dhe një kërkesë të familja Beqiraj janë 400 metra rrugë, nëse ka mundësi.

10.Florjan Bajraktari - Nga fshati Koshutan në këtë vit me mjetet tona kemi bërë zgjerimin e rrugës, që na dërgon te shtëpia e të parëve tanë të Kadri dhe Hysen Bajri dhe kërkesa jonë është, që sipas mundësive të juaja të bëni asfaltimin e rrugës tonë me gjatësi rreth 1.5 km.

11.Rabe Nikçi - I kam disa kërkesa e kam rrugën "Reka e Allagës" e "Qafa e Broqit", e cila i lidh këto dy fshatra, të vazhdojë deri në "Breg të Lopëve", se është rrugë, që na lidh me rrugën për Peklen, i kemi edhe disa rrugica në fshat rruga e "Ahishtes", si edhe për ujësjellës, a ka diçka?

12.Genc Kelmendi – Nga fshati Haxhaj për një rrugë, që lidhen fshatrat Haxhaj me Stankaj se s'kemi qasje në pronat tona janë rreth 1060 metra.

13.Adem Nikçi – Jam nga fshati Shtupeq i Madh kemi nevojë për një rrugë. Kryetari është i njoftuar.

14.Agim Nikçi - Deshta me ditë çka po bëhet me rrugët në Rugovë apo të qohemi ne rugovasit të bëjmë diçka vetë se na kanë lanë si mos me qenë pjesë e Kosovës.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Takimet për dëgjimet buxhetore do të vazhdojnë dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat e qytetarëve.

Kryetari Muhaxheri takimin e mbylli në ora 19:15.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ
















**LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË DEGJIME BUXHETORE PËR
2026, FSHATRA E RUGOVËS**

Vendi: **Salla e Kuvendit Komunal**

Data: **04.08.2025**

Ora: **18:00**

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	Erald Salihaj	Pjesmarre	[Signature]
2	Demet Salihaj	Kugishtë	[Signature]
3	Adem Vllakaj		
4	Flamur Rexhepaj	BT. Boga	[Signature]
5	Musliu Began	BT. Boga	[Signature]
6	Genç Selimaj	HAJHaj	[Signature]
7	Bislim Avdyli	HAJHaj	[Signature]
8	Naim Zallaj	STANKAJ	[Signature]
9	Iskender Budim	STANKAJ	[Signature]
10	Tahir Zallaj	STANKAJ	[Signature]
11	DIART ZALLAJ	STANKAJ	[Signature]
12	ISLAM BAJRAKTARI	GUNISHT	[Signature]
13	BITORI MUJAJ	DUGRIVË	[Signature]
14	Lamir Dary	[Signature]	[Signature]
15	Rogë Nikçi	R. Allaqos	[Signature]
16	Jenir Dary	SH. i Dary	[Signature]
17	Jeton Dary	SH. i Dary	[Signature]

18	Isuf Zaj	Shiroj	
19	Zeqir Halim		
20	SHABAN DAIQI	PEPAT	
21	ZENEL MURIQI	KOSHTAN	
22	AGIM HAXHIQI	BOGE	
23	MUSE REVIAJ	SHKREL	
24	ARBEN LAJQI	DRELAJ	
25	EMRIM LAJQI	DRELAJ	
26	AGIM O. NIKOJ	REKË DALLAQI	
27	XHEVAT OSMAN	KUQINTE	
28	Kaltrina Lajqi	Malaj	
29	GABRINO TURAN	K.K.P626	
30	FATIR IZATI	K.K.P626	
31	SHKESA LUKAJ	K.K.P626	
32	DRITA KASNIQI	K.K.P626	
33	ABDULLA MUSTA BASRIKARI	D.M.S	
34	SHQIPRIJA MURIQI	KOSHTAN	
35	HADRIS HAXHIQI	K.K.P626	
36	Diellza Beushi	K.K.P626	
37	Gazmend Muharrem	K.K.P626	
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			
49			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – Me banorët e fshatrave Trestenik, Nabërgjan, Treboviq, Ruhot, Lutogllavë, Llabjan, Bllagajë dhe Nakull

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Shkolla fillore "Ali Kelmendi", në Nabërgjan

Takimi ka filluar në ora: 16:30

Datë: 05.08.2025

Në ambientet e shkollës fillore "Ali Kelmendi", në fshatin Nabërgjan, në ora 16:30 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave: Trestenik, Nabërgjan, Treboviq, Ruhot, Lutogllavë, Llabjan, Bllagajë dhe Nakull, në kuadër të procesit të hartimit të projekt-buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2026.

Këto dëgjime janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik, me qëllim të përfshirjes aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor.

Gjatë takimeve, po mblidhen kërkesat nga përfaqësuesit e secilit lokalitet për të përcaktuar më pas prioritetet në përputhje me kapacitetet financiare të komunës.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili përshëndeti të pranishmit dhe u uroi mirëseardhje, duke theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Diellëza Berisha, prezantoi ndarjen e buxhetit komunal për vitin 2026, i cili kap vlerën totale prej 41,953,838.00 euro, të ndarë në pesë kategori ekonomike:

Paga dhe medijtje: 21,096,340.38 €

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00 €

Shpenzime komunale: 1,107,240.00 €

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00 € (me rritje 10% nga viti paraparak) dhe

Shpenzime kapitale: 12,938,317.62 €.

Ajo theksoi se ndarja aktuale është ende në fazë paraprake dhe mund të pësojë ndryshime pas pranimi të Qarkores së Dytë Buxhetore nga Ministria e Financave.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe i parashtroni kërkesat e juaja.

1. Beqir Kuqi – Unë kam parashtruar kërkesa disahere dhe nuk janë realizu, te na nuk ka ndriçim, prej përmendores e tutje, prandaj dërgojeni një komision le t'i shikojnë a janë të vërteta apo jo, pastaj rrugët për asfaltim janë 250 metra te shtëpiat tona, te Kuqianët, emri i rrugës "Ekrem Berisha".

2. Hasan Dreshaj – Janë dy çështje shumë të rëndësishme është fjala për mbeturinat inerte, që janë disa kamiona mbeturina, dhe paraqesin rrezik për banorët dhe ata, të cilët i kanë tokat afër, aty duhet një investim kapital, pastaj kjo rruga, prej kafës këtu e gati deri te xhamia të ekzistoj mundësia e një trotuari, sepse deri në asfalt e kanë mbulu therrat, pra ka hapësirë të mjaftueshme, që mundet me u investu, pastaj vendosja e disa pengesave për ngadalësimin e shpejtësisë, sepse mund të ketë pasoja shumë të rrezikshme, si dhe duhet të jetë një patroll e policisë.

3. Xhevat Sukaj – Te rruga e "Ali Ademit" me pas mundësi me na i vendos disa trupa ndriçues.

4. Nezir Berbati – Krahas shumë problemeve, që i kemi në fshatin Nabërgjan unë dua me potencu një problem të kanalizimeve, prej shkollës ekonomike e deri te ne në Ruhot është kanali i hapur, prej 1965, ne jemi para shpërthimit të një epidemie, ujërat e zeza vazhdimisht derdhen, njerëzit janë shumë të rrezikuar. A ka mundësi komuna me ndiku diçka në bashkësi të ujërave, të paktën të pastrohet njëherë?

Edhe një segment të rrugës më duhet me potencu është fjala për rrugën "Halil Berbati" e deri te lagjja e "Ibërdemajve", 150 metra, i lidh lagjet. Po ashtu, edhe për ndriçim publik diçka kanë fol?

5.Agim Haxhiaj - Po lidhem me çështjen e kanalit, që e potencio Nezir Berbati, ai kanal është t'u betonu, prej Katundit të Ri e deri në Vitomiricë, janë t'u vazhdu punimet, ndërsa për hapje nesër kush të do le të vjen me mua unë shkoj te Kompania e Mirëmbajtjes së Ujërave edhe e marrim bagerin edhe e hapin kanalin. Sa i përket vendosjes së policëve të shtrirë unë kam pas një bisedë telefonike me Komandantin e Njësisë Rajonale të Pejës për Komunikacion ata kanë dal si komision me i verifiku, sa i përket shkurreve ne si pronar të tokave ku janë shkurret duhet t'i largojmë vetë, sa i përket fshatrave Treboviq e Bllagajë së pari dua t'ju falënderoj për sallën e sporteve në Treboviq, ndërsa kërkoj, që të investohet në shkollën në Treboviq, ambienti i jashtëm dhe i brendshëm, ndërsa rrugët në këto dy fshatra janë 98 përqind të përfunduara, ndërsa ndriçimi duhet të përfundoj prej shkollës fillore "Skënderbeu" e deri në kodra se ka shumë nxënës, që vijnë natën nga shkolla. Të gjitha kërkesat do t'i dorëzoj me shkrim.

6.Ahmet Hajdari - Prej shkollës 150 metra janë rrugë për asfaltim kam fol disahere për këtë rrugë.

7.Ali Dreshaj – Unë kërkoj nga komuna nëse ka mundësi të na i pastroj fushat nga mbeturinat, sepse fajet i kemi na vetë.

8.Imer Krasniqi – Më kanë premtu vjet për një rrugë, që e kanë shti në projekt deshta me ditë a ka diçka të re?

9.Arben Morina - Sa i përket kanaleve të ujitjes jemi shumë keq, që tri vjet i kemi vetëm 400 metra edhe aty nuk shkon uji, i kam 1500 metra kanal në Lutogllavë edhe 2300 metra në fshatin Trestenik.

10.Jeton Dreshaj –Kemi nevojë shumë për ndriçim publik.

11.Ramiz Dreshaj – Kemi shumë problem me ujërat e zeza.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Dëgjimet buxhetore do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, ndërsa po evidentohen të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2026.

Kryesuesi Kurtbogaj takimin e mbylli në ora 17:35.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË DEGJIME BUXHETORE PËR
2026, Trestenik, Nabërgjan, Trebovë, Ruhot, Lutogllavë, Llabjan, Bllagajë, Nakull**

Vendi: Shkolla fillore në Nabërgjan

Data: 05.08.2025

Ora: 16:30

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	Shqiponja Lajç	NABERGJAN	
2	Shqiponja Lajç	NABERGJAN	
3	BURIM KASTURAJ	NABERGJAN	
4	Fitim Dredaj	NABERGJAN	
5	Dunut Ibrahimaj	NABERGJAN	
6	Adle Ibrahimaj	NABERGJAN	
7	ARBEN BERENJAN	NABERGJAN	
8	ASLIAN JAHUZOJ	NABERGJAN	
9	Abnet Hajdaj		
10	XHEVAJ SUKUA	NABERGJAN	
11	Adnan Dredaj	NABERGJAN	
12	Ali Dredaj	NABERGJAN	
13	Fitim Dredaj	NABERGJAN	
14	Fitim Dredaj	K. TREBOVIA	
15	Arben Moshaj	TRUSTNIK	
16	IMER KRASNIQ	NABERGJAN	
17	Jeton Dredaj	NABERGJAN	

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	KAMIZ DRESHA	MABEK 6/11	
19	ERDOND TURKU	15-6	
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – Me banorët e fshatrave: Vitomiricë, Katundi i Ri, Brestovik, Lipë, Dubovë dhe Ozdrim.

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Qendra Rinore në Vitomiricë

Takimi ka filluar në ora: 18:00

Datë: 05.08.2025

Në ambientet e Qendrës Rinore në Vitomiricë, në ora 18:00 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave: Vitomiricë, Katundi i Ri, Brestovik, Lipë, Dubovë dhe Ozdrim, në kuadër të procesit të hartimit të projekt-buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2026.

Këto dëgjime janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik, me qëllim të përfshirjes aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor.

Gjatë takimeve, po mblidhen kërkesat nga përfaqësuesit e secilit lokalitet për të përcaktuar më pas prioritetet në përputhje me kapacitetet financiare të komunës.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha, Nënkryetari i Komunës, z.Fatmir Asllani, Nënkryetari për Komunitete, z.Mirzet Džogović, Drejtori për Shërbime Publike dhe Punë Komunale, z.Agron Nikçi dhe Drejtori për Çështje

Pronësoro-Juridike, z.Arianit Krasniqi.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha, prezantoi ndarjen e buxhetit komunal për vitin 2026, i cili kap vlerën totale prej 41,953,838.00 euro, të ndarë në pesë kategori ekonomike:

Paga dhe meditimje: 21,096,340.38 €

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00 €

Shpenzime komunale: 1,107,240.00 €

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00 € (me rritje 10% nga viti paraprak) dhe

Shpenzime kapitale: 12,938,317.62 €.

Ajo theksoi se ndarja aktuale është ende në fazë paraprake dhe mund të pësojë ndryshime pas pranimi të Qarkores së Dytë Buxhetore nga Ministria e Financave.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Shkumbin Prekaj - Kryetar i Bashkësisë Lokale Dubovë dhe Ozdrim ne i kemi pas disa kërkesa vazhdimisht edhe pse shumica, prej tyre janë përfunduar, por ka edhe të tjera, që për vite më radhë për shkak të buxhetit janë shtyrë për vitet e ardhshme, si vijim është ndriçimi i fshatit Ozdrim, si dhe rrethojat e fshatit, trotuari nga shkolla fillore e deri te varrezat, salla e sportit në shkollën fillore, rrethojat e shkollës fillore, asfaltimi 420 metra, dhe kanalet e ujitjes 800 metra.

2.Qerim Krasniqi -Kryetar i Bashkësisë Lokale në Vitomiricë ju falënderoj për punët, që kanë përfunduar, por kemi edhe kërkesa të tjera për rrugën transitore, e cila është asfaltu po është në gjendje të dobët edhe ndriçimi ka nevojë, si dhe rruga te ambulanta me rrugën, që shkon për Radavc ka nevojë për asfaltim, rruga te stacioni i ri ka nevojë për asfaltim dhe ndriçim, si edhe kemi nevojë për ujësjellës.

3.Muhamet Shala - Shumicën e kërkesave i përmendi z.Prekaj, por kemi edhe një shqetësim, si banorë e si prindër me intervenu te shkolla në fshatin Ozdrim për një nënkalim se i kemi fëmijët e rrezikuar dhe me ju falënderu për punët e mira, që i keni bërë deri më tash.

4.Rexhë Hysenaj - Ne kemi nevojë për rrugë, që i lidh dy fshatra, sepse do të ishte në interes të të gjithë qytetarëve.

5.Izet Kojiç - Përshëndetje për të gjithë ne po kemi problem me këto shkurret këtu para Qendrës Rinore në Vitomiricë, me pas mundësi me i largu.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Dëgjimet buxhetore do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, ndërsa po evidentohen të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2026.

Nënkryetari Džogović takimin e mbylli në ora 19:00.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ


**LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË DEGJIME BUXHETORE PËR
2026, Vitomeriçë, Katundi i Ri, Brestovik, Lipë, Dubovë, Ozdrim**

Vendi: Qendra Rinore në Vitomeriçë

Data: 05.08.2025

Ora: 18:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
		VENDI	
1	MUHAMET LASHI	VITOMERIC	Moj
2	Fazli Haxhaj	-	Fazli
3	Kendi Hysaj	LIPË	Kendi
4	ARIANIT KRASHICA	NOVOSOLL	Arianit
5	QERIM KRASHICA	VITOMIRIÇË	Qerim
6	SAMI GASHI	OZDRIM	Samir
7	Muram Shala	OZDRIM	Muram
8	Rajsa Nurkovic	Vit	Rajsa
9	AGRON NIKCI	VITOMERICË	Agon
10	PET UOTIC	VITOMIRIÇË	Pet
11	RAK ZEKU	KATUNDI RI	Rak
12	Ahmet Shala	Vitomeriçë	Ahmet
13	SHKURBI PRORIN	NOVOSOLL	Shkurbi
14	ARGEN DAE	VITOMIRIÇË	Argen
15	KIR DELIJAS	VITOMIRIÇË	Kir
16	NIMON MEHMETAJ	NOVOSOLL-VITOMIRIÇË	Nimon
17	ALBERIN ZOGU	DUBOVË	Alberin

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	CAJ DACI	VITOMERIC	
19	Valbona Beqar	OSCE	
20	GABRIEL TULLI	1026	
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – Me banorët e fshatit Gorazhdec

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Qendra Rinore në Gorazhdec

Takimi ka filluar në ora: 16:00

Datë: 06.08.2025

Sot, është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatit Gorazhdec, në kuadër të procesit të hartimit të projekt-buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2026.

Këto dëgjime janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik, me qëllim të përfshirjes aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor.

Gjatë takimeve, po mblidhen kërkesat nga përfaqësuesit e secilit lokalitet për të përcaktuar më pas prioritetet në përputhje me kapacitetet financiare të komunës.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri dhe Nënkryetari për Komunitete në Komunën e Pejës, z.Mirzet Džogović.

Zyrtari për Certifikim në Komunën e Pejës, z.Fatmir Imami e prezantoi ndarjen e buxhetit

komunal për vitin 2026, i cili kap vlerën totale prej 41,953,838.00 euro, të ndarë në pesë kategori ekonomike:

Paga dhe medijtje: 21,096,340.38 €

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00 €

Shpenzime komunale: 1,107,240.00 €

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00 € (me rritje 10% nga viti paraprak) dhe

Shpenzime kapitale: 12,938,317.62 €.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Dusan Poric - Pastrimi i terrenit të lojrave për fëmijë (terreni është përvetësuar nga AKP, si pronë publike, e cila do të shitet).

2.Jugo Dunic - Ndërtimi i kanalizimit, lumi është i pashfrytëzueshëm nga kundërmimet sepse derdhen kanalizimet në të, a ka mundësi që këto derdhje të ndërpriten? A ka mundësi për shfrytëzimin e ujit për ujitje, i cili del nga fabrika e përpunimit të ujit?

3.Darko Dimitrijevic - Kush është kompetent për rrymë, mungesa e rrymës, e cila mungon thuhet gjatë tërë ditës të gjitha gjërat ushqimore prishen në frigorifera për ngrirje të thellë, a keni mundësi, që të bëni takime me KEDS-in, që kjo gjendje të tejkalohet. Shtëpia e kulturës në Gorazdec është në gjendje të mjerueshme, a keni mundësi, që të investoni në sanimin e saj të rregullohet podi, kulmi, i cili e lëshon ujin, dritaret të vendosen të reja dhe të vendosen disa klima. Kjo shtëpi është e pashfrytëzueshme dhe ka mundësi të shfrytëzohet nga të rinjtë për aktivitete kulturore, si dhe për takime të ndryshme nga qytetarë të tjerë.

Kryetari Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Dëgjimet buxhetore do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, ndërsa po evidentohen të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2026.

Nënkryetari Džogović takimin e mbylli në ora 17:00.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ


LISTA POTPISA PRISUTNI NA BUDZETSKO SASLUSAVANJE ZA GODINU 2026,
Selo Gorazhdec

Mesto: Qendra Rinore në Gorazhdec

Datum: 06.08.2025

Vreme: 16:00

Br.	IME I PREZIME	MESTO	POTPIS
1	Milić Petrović	GORAZDEVAC	M. Petrović
2	MILAN Paulović	GORAZDEVAC	M. Paulović
3	MILAN Poretić	GORAZDEVAC	M. Poretić
4	Торинг Џуман	Торингевос	Торинг
5	Бедо Џорџевић	Торингевос	Бедо
6	Радко Њаксич	GORAZDEVAC	Радко
7	KATALINA MANOJLOVIĆ	GORAZDEVAC	KM
8	DRAGOJUB MAKSIĆ	GORAZDEVAC	DM
9	DRACAN MUKOŠE	GORAZDEVAC	DM
10	Ранко Џуманџић	Торингевос	РД
11	Бенедикт Милан	Торингевос	Бенедикт
12	Ранко Џорџевић	- II -	РД
13	Ненад Њаксич	GORAZDEVAC	Ненад
14	Ружан Џуманџић	- II -	РД
15	MARINA MAKSIĆ	- II -	MARINA MAKSIĆ
16	Бенедикт Џорџевић	- II -	Бенедикт
17	Милош Џуманџић	- II -	Милош

Br.	IME I PREZIME	MESTO	POTPIS
18	DARIO DIMITRIJEVIC	GORAZDOVAC	
19	JACOB C. MILAN	GORAZDOVAC	
20	CHRISTIAN TULL	1826	
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – Me banorët e fshatrave të Podgurit

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Vendi: Shkolla fillore në Novosellë

Takimi ka filluar në ora: 17:30

Datë: 06.08.2024

Në ambientet e shkollës fillore në Novosellë, në ora 17:30 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave të Podgurit, në kuadër të procesit të hartimit të projekt-buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2026.

Këto dëgjime janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik, me qëllim të përfshirjes aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor.

Gjatë takimeve, po mblidhen kërkesat nga përfaqësuesit e secilit lokalitet për të përcaktuar më pas prioritetet në përputhje me kapacitetet financiare të komunës.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha, Drejtoresha për Mirëqenie Sociale, znj.Albulena Mujaj Bajraktaraj, Drejtoresha e Inspektionit,

znj.Edonjeta Berisha, Drejtori për Çështje Pronësores-Juridike, z.Arianit Krasniqi dhe Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, z.Tahir Shala.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha, prezantoi ndarjen e buxhetit komunal për vitin 2026, i cili kap vlerën totale prej 41,953,838.00 euro, të ndarë në pesë kategori ekonomike:

Paga dhe medijtje: 21,096,340.38 €

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00 €

Shpenzime komunale: 1,107,240.00 €

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00 € (me rritje 10% nga viti paraprak) dhe

Shpenzime kapitale: 12,938,317.62 €.

Ajo theksoi se ndarja aktuale është ende në fazë paraprake dhe mund të pësojë ndryshime pas pranimit të Qarkores së Dytë Buxhetore nga Ministria e Financave.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Sylë Peli - Jam përfaqësues i fshatit Novosellë zakonisht, po marrim kritika nga personat, të cilët nuk vijnë kurrë në takime jam munduar në mënyrën më të mirë të mundshme t'i përfaqësoj interesat e fshatit, pothuajse të gjitha kërkesat janë realizu, por kemi edhe kërkesa të tjera për vitin 2026 kemi nevojë, që prej urës e deri te xhamia të pastrohet zhavorri, mirëmbajtja po na mungon shumë në fshat, urgjentisht na duhet një parking në rastet kur po kemi raste të vdekjes. Pastaj, ndriçimi në fshat është në rregull, por janë disa drita, që kanë nevojë për rishikim.Të paktën çdo fshat ta ketë ka një punëtor, që të kujdeset për fshtin dhe t'i sigurohet një pagë simbolike.

2.Ukë Selimaj - Unë i kam tri pika, që deshta me i theksu është problem kanalizimi, i cili ka qenë investim i qeverisë qendore, por në bashkëpunim me Komunën, ka mbet në gjysë se banoret pyesin se i përfshin pesë fshatra, ndriçimi publik në lagjen atje lart ku jam unë, rregullimi i varrezave të fshatit ose një mur rrethues.

3.Shaqir Muçaj - Ju kemi drejtu me disa kërkesa për çështjen e transportit të fëmijëve, e kemi transportin privat, por ai e ka rrit shumë çmimin ka familje, që i ka disa fëmijë në shkollë e nëse Drejtoria e Arsimit me na e siguru naftën, si dhe e ka bërë autobusin

shumë të vogël.

4.Jakup Blakaj -Jam nga Radavci ju përsihendes të gjithëve me juve Kryetar pata bisedu për kanalizim dhe më the se s'ka mjete buxhetore, por kemi nevojë për ndriçim dhe trotuar.

5.Imer Mujaj - I kam disa kërkesa të banorëve, te asfaltimi i disa rrugicave, sepse rrugët kryesore janë përfundu, pastaj te na s'ka transport publik për nxënës dhe banorë, në hymje të fshatit te rruga kryesore një shesh është i nevojshëm për banorët, qendra e fshatit ku është ndërtu Shtëpia e Kulturës, ndërsa në bujqësi jemi më së keqi rrugët fushore në Jabllanicë të Vogël janë të pakalueshme, edhe te kanalet e ujitjes kemi shumë problem me ujë me dërgu deri te arat, si dhe kemi nevojë për dy mure mbrojtëse.

6.Lindar Azemaj – Jam prej Radavci përsihendetje për të gjithë na në Radavc infrastrukturën se kemi keq, por disa kanale të ujitjes, që kanë projekte janë shumë të nevojshme, si dhe kemi nevojë për një mur mbrojtës te kthesa, si dhe rruga kryesore e Radavcit, nëse ka mundësi me rregullu, si dhe ndriçimi në park dhe te ambulanta e fshatit nuk është në rregull.

7.Donjeta Bërdynaj – Një rrugë rreth 200 metra, në lagjen "Bërdynaj" dhe një kanal i ujitjes rreth 120 metra.

Kryetari Muhaxheri i përsihendeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Dëgjimet buxhetore do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, ndërsa po evidentohen të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2026.

Drejtoresha për Mirëqenie Sociale në Komunën e Pejës, znj.Albulena Mujaj – Bajraktaraj takimin e mbylli në ora 18:40.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË DEGJIME BUXHETORE PËR
2026, Fshatrat e Podgurit**

Vendi: Shkolla fillore në Novosellë

Data: 06.08.2025

Ora: 17:30

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
		VENDI	
1	Sylë Peli	NOVOSELLE	
2	LIKE SELIMAJ	NOVOSELLE	
3	Zekrija Pelaj	NOVOSELLE	
4	Avenitë Peli	NOVOSELLE	
5	SHAGRIZ HURAJ	J.E. M.	
6	DORRAT DORRAGAJ	NOVOSELLE	
7	JAKUP BLADAJ	RADAC	
8	ORLEN BARRAKTARAJ	RADAC	
9	Juan Jari	J.E. VOGEL	
10	Valdrim Rexhaj	J.E. Vogel	
11	RIKAT HURAJ	RADAC	
12	LINDAN KZEMAJ	RADAC	
13	GRIGOR TUKU	BZB	
14	Fatma Tugan	fatma:	
15	SHIPREST LUKAJ	K.E. PULIC	
16			
17			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – Me gra, vajza, klube sportive të vajzave, si dhe organizata, të cilat merren me çështje gjinore.

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Kuvendi Komunal në Pejë

Takimi ka filluar në ora: 16:00

Datë: 07.08.2025

Sot, në ora 16:00, në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur dëgjimi buxhetor me gra, vajza, klube sportive të vajzave, si dhe organizata, të cilat merren me çështje gjinore, në kuadër të procesit të hartimit të projekt-buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2026.

Këto dëgjime janë organizuar nga Kryetari, i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik, me qëllim të përfshirjes aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor.

Gjatë takimeve, po mblidhen kërkesat nga përfaqësuesit e secilit lokalitet për të përcaktuar më pas prioritetet në përputhje me kapacitetet financiare të komunës.

Gjatë takimeve, po mblidhen kërkesat nga përfaqësuesit e secilit lokalitet për të përcaktuar më pas prioritetet në përputhje me kapacitetet financiare të komunës.

Në këto takime kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha dhe Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi në Komunën e Pejës, z.Tahir Shala.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha, prezantoi ndarjen e buxhetit komunal për vitin 2026, i cili kap vlerën totale prej 41,953,838.00 euro, të ndarë në pesë kategori ekonomike:

Paga dhe medijtje: 21,096,340.38 €

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00 €

Shpenzime komunale: 1,107,240.00 €

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00 € (me rritje 10% nga viti paraprak) dhe

Shpenzime kapitale: 12,938,317.62 €.

Ajo theksoi se ndarja aktuale është ende në fazë paraprake dhe mund të pësojë ndryshime, pas pranimi të Qarkores së Dytë Buxhetore nga Ministria e Financave.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Gazmend Zeneli – Jam qytetar i Pejës, përkatësisht jetoj te pjesa e stacionit të autobusëve, qytetarët ankesa kanë tërë ditën, ndërsa asnjë nuk janë prezent, nuk kanë interes asgjë për të mirën e qytetit, ndërsa këtu te fletushka e investimeve e pashë, që këtu te pjesa e investimeve a lidhet pjesa ka banka, prej stacionit të autobusëve lart apo është vetëm pjesa kryesore? Po ashtu, kam një lutje, që te rruga jonë "Vëllezërit Topulli", ku ndertimi i shtëpive ka bërë dëmtimin e rrugës, nuk ka javë, që s'kemi probleme, kam bërë kërkesë disaherë për rregullimin e ndriçimit rrugor?

2.Mirsada Zeneli – Përshëndetje për të gjithë jam një ndërmarrëse e vogël, merrna me përpunimin e pemëve dhe perimeve, me përfitimin e grantit organizata austriake në bashkëpunim me komunën ma ka dhuru një grant, jam pajis me makineri moderne,

më kanë lehtësu shumë punën, që nga zemra i falënderoj komunën, e sidomos në vitet e fundit ka shumë përkrahje për fermerë e bujq dhe është ringjall bujqësia në përgjithësi.

3.Drita Krasniqi - Duke e pas parasysh sa i rëndësishëm është buxheti mosprania e qytetarëve dhe OJQ-ve është për t'u dëshiruar sepse në këto planifikime duhet të marrin pjesë. Shqetësimi im më i madh është se duhet të mendoj komuna se buxheti duhet të ndahet në bazë gjinore dhe me përqindje, si dhe shëndeti mental dhe siguria në shkolla është shumë domethënëse. I pashë disa projekte, që janë të parapara të realizohen në vitin 2026, pra i mirëpresim dhe besoj, që kanë me pas shumë rëndësi në rregullimin e jetës së qytetarëve. Organizatat dhe subvencionet duhet të rriten për organizatat rinore në nivel komune, si në biznese të reja dhe gra, të cilat korrin suksese e të përkrahen edhe më shumë.

Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Dëgjimet buxhetore, po vazhdojnë dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2026.

Nënkryetari Asllani takimin e mbylli në ora 16:50.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË DEGJIME BUXHETORE PËR 2026, Dëgjim
buxhetor me gra, vajza, klube sportive të vajzave, si dhe organizatat, të cilat merren me çështje gjinore

Vendi: Asamble Komunale

Data: 07.08.2025

Ora: 16:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA VENDI	NËNSHKRIMI
1	Rrudhe Kelmendi	KOSURIQ	R.K
2	MIRSADA ZENELI	SHPK. MIKA	MZ
3	GAZHEND ZENELI	SHPK. MIKA	GZ
4	MUSTA PROKSHI	Helvetos	MP
5	GANI ZENEHI	PEJE	GP
6	COBIRAN TURICU	PEJE	CT
7	FATMIR IMAMI	PEJE	FI
8	SHPRESA LUKAJ	K.K. PEJE	SL
9	DRITA KRASNICA	K. PEJE	DK
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – Me banorët e fshatrave Dobërdol, Llozhan, Graboc, Poçestë, Millovanc, Pishtan, Loxhë, Zllapek, Raushiq dhe Lubeniq.

Shkolla fillore në Raushiq

Takimi ka filluar në ora: 17:30

Datë: 07.08.2025

Sot, janë mbajtur dëgjimet buxhetore me banorët e fshatrave Dobërdol, Llozhan, Graboc, Poçestë, Millovancë, Pishtan, Loxhë, Zllapek, Raushiq dhe Lubeniq.

Dëgjimet buxhetore janë duke u mbajtur në kuadër të procesit të hartimit të projekt-buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2026.

Këto dëgjime janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik, me qëllim të përfshirjes aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor.

Gjatë takimeve, po mblidhen kërkesat nga përfaqësuesit e secilit lokalitet për të përcaktuar më pas prioritetet në përputhje me kapacitetet financiare të komunës.

Në këto takime kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Nënkryetari i

Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha dhe Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi në Komunën e Pejës, z.Tahir Shala.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha, prezantoi ndarjen e buxhetit komunal për vitin 2026, i cili kap vlerën totale prej 41,953,838.00 euro, të ndarë në pesë kategori ekonomike:

Paga dhe medijtje: 21,096,340.38 €

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00 €

Shpenzime komunale: 1,107,240.00 €

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00 € (me rritje 10% nga viti paraprak) dhe

Shpenzime kapitale: 12,938,317.62 €.

Ajo theksoi se ndarja aktuale është ende në fazë paraprake dhe mund të pësojë ndryshime pas pranimin të Qarkores së Dytë Buxhetore nga Ministria e Financave.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Anisa Fetahaj - Pas takimit të mbajtur me Kryetarin e Bashkësisë Lokale, z.Osman Mulliqi, kryesinë e fshatit dhe banorët i kemi listuar disa kërkesa, siç janë: ndërtimi i një çerdhe publike, vazhdimi i projektit të ndërtimit të kanalizimit të segmenteve, ku është i përfshirë rreth 1800 metra, nga lagjja "Babanaj" e deri në Raushiq, lagjja e Mulliqve, Boqollve dhe Thaqve rreth 300 metra, lagjja Dinaj rreth 500 metra, asfaltimi i rrugës lokale, që e lidh fshatin Raushiq me Dardani rreth 550 metra, asfaltimin e rrugëve të fshatit, rreth 1800 metra, kanalet e ujitjes, ndërtimin e trotuarit, nga lagjja Veselaj.

2.Xhevdet Zekaj – Prej fshatit Raushiq, kjo vajza e ceki kanalizimin nga fshati Raushiq, na jemi diku 50 shtëpi e me mbet fshati pa kanalizim dhe pa ndriçim, prej lagjes "Babanaj" e deri në kryq, kam qenë disahere edhe te Osmani për këtë çështje.

3.Rexhë Veselaj - Përshëndetje të gjithëve unë e di, që buxheti ndahet në bazë të sipërfaqes dhe banorëve, pra në këtë fletushkë po e shoh, që Raushiqi po delka me një impiant me 22 mijë euro për katër fshatra, se Raushiqi i ka disa biznese të veta, që kontribuojnë në Komunë në tatime. Na kemi problem me ujëra të zeza.

4.Muhamet Mahmutaj – Ju përshëndes të gjithëve unë e kam vetëm një kërkesë për një kanalizim dhe kërkesën e kemi bërë edhe me shkrim.

5.Miftar Avdijaj - Janë dy vjet, që e kam përshtrur një kërkesë për kanal të ujitjes me gjatësi 2500 metra, tani e kemi edhe një kërkesë tjetër zgjerimi i rrugës, prej xhamisë e deri te lagjja jonë, 2 km gjatësia, ndriçimi publik, si dhe me na e asfaltu rrugën deri te varrezat.

6.Avni Voci – Unë jam shumë i kënaqur me punën tënde deri më tash, u fol shumë për kanalizim e unë e kam shtëpinë në fund atje dhe kanalizim nuk kam, ujë nuk kam edhe kanë mbet pesë ose gjashtë drita.

7.Behxhet Alimehaj – Jam prej Lubeniqi është hera e tretë, që marr pjesë në planifikim buxhetor dhe kërkesat janë të njëjta më tregoni cilat nga këto 7 pika do të realizohet në buxhetin e ardhshëm? Lidhja e kanalizimi me impiant, ndriçimi i dy lagjeve komplet, oda e fshatit, kanalet e ujitjes, që kanë mbet në gjysmë dhe përfundimi i rrugëve të planifikuara?

8.Fisnik Shala -Kërkesat tona janë asfaltimi i rrugës "Valon Shala" 500 metra, asfaltimi i rrugëve brenda lagjeve te fshatit rreth 1500 metra, ndërtimi i kanaleve të ujitjes me gjatësi 2500 metra, ndërtimi i shtëpisë së fshatit, zgjerimi i kanalizimit në rrugën "Ara e Madhe", siç e quajmë ne 400 metra dhe ndërtimi i këndit për fëmijë, pra këto janë kërkesat për fshatin Loxhë.

9.Bekim Malushaj - Kemi kërkesë rregullimin e grazhdeve, keni punu mjaft, po kërkesa kemi prapë. Po ashtu, ne kemi bërë një kërkesë për palestër, në fshatin Llozhan edhe numri i nxënësve është mjaft i madh, pra brenda mundësive buxhetore.

10.Egzon Kastrati - Na i kemi disa kërkesa të fshatit Dobërdol e para është ndriçimi i fshatit, kanali i ujitjes, që ne e quajmë kanali i ujitjes te Riza, në gjatësi 650 metra, edhe një kanal tjetër i ujitjes i njohur për ne si te Zymerajt rreth 250 metra, i kemi edhe disa rrugica të papërfunduara, në gjatësi 600 metra.

11.Idriz Shabaj - Nga Raushiqi i Ri te na përveç tri rrugëve, të cilat janë asfaltu lagjja "Mekuli", lagjja "Tahiraj" nuk ka ndriçim, lagjja andej ka komunitetet as andej s'ka ndriçim, si dhe kanalet e ujitjes.

12.Rrustem Sumaj - Unë ju falënderoj për punët, të cilat i keni përfundu asfaltimin dhe kanalizimin dhe e kam një pyetje prej rrugës kryesore, prej restorant "Alaskës" e deri te

shkolla në Raushiq ka shumë qarkullim dhe nuk ka trotuare është problem si për fëmijë, si për të rritur.

13.Osman Dinaj - Sa i përket buxhetit është një shumë e mirë nëse bëhet funksionale p.sh. investoni te Bërdynajt në Mulli, ndërsa Barani s'kanë ujë me pi, sa i përket kanaleve fekale, pastaj një trotuar këtu në Raushiq ka mbet keq, sepse ka lëvizje të nxënësve.

14.Bekim Morina - I kam disa kërkesa për fshatin Vragoc kanalet e ujitjes, si dhe ndriçimin publik.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Dëgjimet buxhetore, po vazhdojnë dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2026.

Kryesuesi Kurtbogaj takimin e mbylli në ora 19:00.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ












LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË DEGJIME BUXHETORE PËR 2026,
Dobërdol, Llozhan, Graboc, Poçestë, Millovanc, Pishtan, Loxhë, Zllapek, Raushiq dhe Lubeniq

Vendi: Shkolla fillore në Raushiq

Data: 07.08.2025

Ora: 17:30

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	SALI VESELA	RAUSHIQ	
2	Shafzet Xhafuzi	Raushiq	
3	Jismuh Ghalen	LOXHË	
4	EGZON SHALA	LOXHË	
5	LUZIM MEKUCI	RASHI I RI	
6	NAIM BARUHA	RAUSHIA IE	
7	JETON DINAI	RAUSHIQ	
8	Bekim Morina	LOXHË	
9	Sherif Krasniqi	Lybeniq	
10	Rustem Sumaj	Lybeniq	
11	Muftar Aliji	ZILAPEK (Palabandit)	
12	Agnesa Morina Aliji	ZILAPEK (Palabandit)	
13	Alem Demaj	Llozhan	
14	Beke Malushi	LLOZHAN	
15	AGRON DEMAJ	LLOZHAN	
16	Gentiana Fetahaj	Raushiq	
17	Anisa Fetahaj	Raushiq	

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	Ogaston Muehzi	K.L. Raushiq	Muehzi
19	Egzon Kastrati	DOBERDOR	
20	Perçet	Flërneshiq	
21	Florentina Ademaj Fetahaj	Raushiq	
22	Aspit Krasniq	POÇKSTË	Krasniq
23	Adole Krasniq	Pezhë	
24	Wendel Zeleni	RASHIBIA	
25	Fatmir Ismaj	KEPOJ	
26	Nisret Ademaj	Raushiq	
27	Isa Mahmutoz		
28	Muhamet Mahmutoz		
29	SHAIM ALIMEHAJ	Lybeniq	
30	FLAKON FETAHJ	RAUSHIQ	
31	Admir VEGA	RAUSHIQ	
32	IPRIT SHABAN	RAUSHIQ	
33	Nezir Jahman	Lybeniq	
34	VEHBI KASTRATI	RAUSHIQ	
35	Shpet Tustaiti	Raushiq	
36	GABRIEL TURKI	1826	
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – Me banorët e fshatrave të Lugut të Baranit

Shkolla fillore në Baran

Takimi ka filluar në ora: 17:30

Datë: 08.08.2025

Në ambientet e shkollës fillore "Dëshmorët e Kombit", në Baran, nga ora 17:30 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave të Lugut të Baranit, në kuadër të procesit të hartimit të projekt-buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2026.

Këto dëgjime janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik, me qëllim të përfshirjes aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor.

Gjatë takimeve, po mblidhen kërkesat nga përfaqësuesit e secilit lokalitet për të përcaktuar më pas prioritetet në përputhje me kapacitetet financiare të komunës.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha dhe Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, z.Tahir Shala.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha, prezantoi ndarjen e buxhetit komunal për vitin 2026, i cili kap vlerën totale prej 41,953,838.00 euro, të ndarë në pesë

kategori ekonomike:

Paga dhe medetje: 21,096,340.38 €

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00 €

Shpenzime komunale: 1,107,240.00 €

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00 € (me rritje 10% nga viti paraprak) dhe

Shpenzime kapitale: 12,938,317.62 €.

Ndarja aktuale është ende në fazë paraprake dhe mund të pësojë ndryshime pas pranimit të Qarkores së Dytë Buxhetore nga Ministria e Financave.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Muhamet Berisha – Nga fshati Kryshec punët kryesore kanë përfunduar të gjitha, por kanë mbetur edhe disa anekse të shkurta rreth 750 metra, e kemi një kanalizim të kahershëm dhe aty janë gypat e ngushtë janë rreth 700 metra edhe me mujt me renovu, edhe për një rrugë kemi nevojë për asfaltim sa metra nuk e di, ndërsa të tjerat janë përfunduar mirë, prandaj po më vjen keq më kërkua prapë.

2.Gani Gashi – Jam nga fshati Bërliq kemi nevojë për kubëzim aty te varrezat.

3.Anton Antoni – E kam një falënderim shumë të veçantë për bashkëpunimin, na i kemi përgatit të gjitha kërkesat dhe do t'i dorëzojmë, te shkolla "Migjeni" janë disa familje, që banojnë aty afër dhe aty grumbullohen të gjitha ujërat e zeza në atë pjesë e kemi kroit e fshatit rreth 20 ose 30 metra largësi, kemi nevojë për një rezervuar dhe te Drejtoria e Bujqësisë kanë mbetur rreth 30 metra. Ju faleminderit shumë për bashkëpunimin e deritanishëm.

4.Agron Kelmendi – Nga fshati Kosuriq faleminderit për çdo gjë, që keni bërë për fshatin tonë. Kërkesat tona do t'i dorëzojmë me shkrim.

5.Atdhe Berisha – Kemi pas bashkëpunim të shkëlqyer me Drejtorinë e Bujqësisë, përveç makinerisë bujqësore edhe në kanalet e ujitjes, por ka nevojë përsëri, kemi nevojë për ndërtimin e dy pendave, e kemi bërë një matje na duhet diku rreth 4000 mijë metra, te kanalet e ujitjes dhe përmbushemi me këtë pjesë, ndërtimin e një rruge te varrezat e fshatit në lagjen "Kamenica". Kam pas problem me printer, por të gjitha kërkesat, që do t'i kem do t'i dorëzoj me shkrim.

6.Veton Dervishaj – Po flas si përfaqësues i fshatit Kotradiq deshta me ju falënderu, që keni ardhë sot këtu, por edhe për të gjitha investimet, që i keni bërë e tash po vazhdoj me i paraqit kërkesat e fshatarëve, siç janë: vazhdimi i kanaleve të ujitjes, ndërtimi i urës, janë edhe disa rrugica në fshat, që kanë mbet, janë të shkurta, si dhe nuk kemi rrjet të kanalizimit.

7.Dritan Gashi – Jam nga Buqani ju falënderoj për investimet, që i keni bërë në fshatin tonë, si për asfalt, si për kanale të ujitjes, na i kemi disa kërkesa te Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe te Drejtoria e Bujqësisë, për kanale të ujitjes rreth 1860 metra, si dhe zënia e një pende është e nevojshme për një kanal rreth 250 metra, ndriçimi publik, 300 metra asfalt, rrugica, që kanë mbet.

8.Selmon Krasniqi – Te na kanë përfundë goxha do punë, por kemi prapë punë për kanale, si dhe një shesh afër xhamisë do të na ndihmonte shumë edhe për parkingje, edhe disa rrugica, të cilat besoj janë tenderu, si dhe rrugës kryesore me ja dhanë një shtresë. I dorëzojmë te gjitha kërkesat fizikisht.

9.Demë Gashi – Kryetar i fshatit Baran ne si fshat e dime, që është punu shumë, por duhet të punojmë sa të jemi gjallë, kanë mbet disa imtësira me përfundu e kam një rrugicë reth 80 metra asfalt rreth 300 metra kanal, sepse kur po bjen shi, po shkaktohen shumë probleme, rrethimi i varrezave i kemi edhe 300 metra, kemi nevojë edhe për ndriçim sepse fëmijët dalin dhe shumë familje po ecin andej, prandaj kanë mbet rreth 300 metra pa drita, janë në anën e kundërt ato shtylla i kemi vendos vetë. Po ashtu, për fund e kam një pyetje ku qëndron situata me ujësjellës?

10.Nexhat Gashi – Jam nga fshati Buqan. Kryetar të falënderoj për punën, që e ke bërë, por me ty s'do të marr shumë kohë, por me Drejtorin e Bujqësisë, që të ma jep një përgjigje këtë penden te mullini, që i themi ne unë tash e tri vite e kam këtë problem personal janë 15 hektar tokë, që kanë nevojë për atë pend, kam prit vitin e kalum nga Drejtoria s'ka rezultat pse nuk zihet një pend e fshatit Buqan me një bager me një pagesë të vogël, që me i ujit 15 hektar tokë e me i ndal banorët e fshatit mos me ikë prej fshatit, që tri vjet e përsëriti këtë çështje përpara e kemi zënë vetë tash sistemi politikë në Kosovë e ka prish çdo gjë, por Komuna nuk duhet t'ju jap mundësinë dhe t'i shikoj qytetarët se kush me cilën parti është se toka s'ka të bëjë me parti. Ujë ka e toka është djegur e gjitha, sepse une s'mund ta zë vetë një pend rreth 2000 ose 2500 euro. Nëse vazhdon kështu situata unë vetë vitin e ardhshëm do të tërhiqem nga bujqësia.

11.Nezir Berisha – Unë kisha kërku prej Kryetarit dhe të gjithëve, që në fshatin Buqan, Llugaxhi dhe Nepole janë dhanë disa vite naftë, por me mujt me bë nje zgjidhje, që me mujt me kry punë?

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe u kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju kanë interesuar dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Drejtori i Bujqësisë, z.Shala takimin e mbylli në ora 18:40.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË DEGJIME BUXHETORE PËR
2026, Fshatrat e Lugut të Baranit**

Vendi: Shkolla fillore në Baran

Data: 08.08.2025

Ora: 17:30

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA VENDI	NËNSHKRIMI
1	ATDHE BERISHA	BARAN	
2	BURIM KEMENDI	KOSORIQ	
3	VEJTON DERVISHAJ	KOTRADIQ	
4	ARMAN JHOSHAJ	KOTRADIQ	
5	ANTON ANTONI	B.L. GILGJA	
6	AMIR GASHI	BROLDI	
7	HERIR BUESHA	LLUGAGJI	
8	ADHE BERISHA	GALLAPER	
9	MUHEMET BERISHA	KIRYHEC	
10	TAHIR SHALA	K.K. PESE	
11	BARAN KEMENDI	KOSORIQ	
12	SELMON KRASNIAI	VRANOC	
13	DRITON GASHI	BUCAN	
14	BUYAN POMXHA	KOSUNIQ	
15	AGTON KEMENDI	KOSORIQ	
16	BASIM BERISHA	LLUGAGJI	
17	DEMIR GASHI	BARAN	

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	Herhmedin Duka	CALLAPEK	Herhmedin
19	Nexhat Jashi	BUCAN	Nexhat
20	DURIM KULMENDI	K.K. PEJE	Durim
21	GABRIEL TUCAN	1826	Gabriel
22	SHRRESA LUKA	K. PEJE	Shrresa
23	DELTA KRASINIC	K. Peje	Delta
24	FATMIR IMANI	K.K. Peje	Fatmir
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2026

Procesverbali – Me banorët e fshatrave të Lugut të Leshanit

Shkolla fillore në Qyshk

Takimi ka filluar në ora: 19:00

Datë: 08.08.2025

Në ora 19:00 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave të Lugut të Leshanit, në kuadër të procesit të hartimit të projekt-buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2026.

Këto dëgjime janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik, me qëllim të përfshirjes aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor.

Gjatë takimeve, po mblidhen kërkesat nga përfaqësuesit e secilit lokalitet për të përcaktuar më pas prioritetet në përputhje me kapacitetet financiare të komunës.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani dhe Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha, prezantoi ndarjen e buxhetit komunal për vitin 2026, i cili kap vlerën totale prej 41,953,838.00 euro, të ndarë në pesë

kategori ekonomike:

Paga dhe medetje: 21,096,340.38 €

Mallra dhe shërbime: 5,451,940.00 €

Shpenzime komunale: 1,107,240.00 €

Subvencione dhe transfere: 1,360,000.00 € (me rritje 10% nga viti paraprak) dhe

Shpenzime kapitale: 12,938,317.62 €.

Ajo theksoi se ndarja aktuale është ende në fazë paraprake dhe mund të pësojë ndryshime pas pranimit të Qarkores së Dytë Buxhetore nga Ministria e Financave.

Dëgjimet buxhetore kanë përfunduar dhe janë evidentuar të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2026.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Hasan Shala - Unë kam dëshirë, që kërkesat e të gjithëve të merren parasysh i kemi disa rrugë me zhavorr, që kanë nevojë vetëm të asfaltohen, unë si Kryetar i fshatit nuk kam kanalizim dhe ju e dini shumë mirë, si dhe kemi nevojë për ndriçim publik.

2.Fitim Kelmendi – Jam nga fshati Qyshk e kam një rrugë diku 90 metra gjatësi kam bërë kërkesë në Komunë e kam shtru në zhavorr dhe është e gatshme, po ende s'ka asgjë.

3.Xhavit Nikçi – Që 25 vite merremi me shkollë të futbollit, sa i përket klubit tonë nuk na keni barazu as me shkolla të futbollit fatkeqësisht. Unë shkoj në shumicën e fshatrave të Pejës dhe i marr fëmijët me luft futboll se di pse është anashkalu klubi im se nëse unë ndalna e dinë të gjithë se ata fëmijë më nuk merren me futboll se deri më sot nuk është anashkalu, prandaj do ta tejkaloj këtë situatë. Unë ju falënderoj për gjithçka edhe kam ardhë me shpreh pakënaqësinë teme sepse Kryetari gjithmonë ma ka hap derën. Shpresoj këtë vit me na mbështet më shumë me autobus sepse jemi shumë keq, nëse keni mundësi.

4.Valon Kabashi – Na kemi nevojë për një kanal të ujitjes në fshatin Zahaq rreth 1100 metra.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Dëgjimet buxhetore kanë përfunduar dhe janë evidentuar të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2026.

Nënkryetari Asllani takimin e mbylli në ora 19:40.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË DEGJIME BUXHETORE PËR
2026, Fshatrat e Lugut të Leshanit**

Vendi: Shkolla fillore në Qyshk

Data: 08.08.2025

Ora: 19:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	XHAJIT NIKO	KE. DARDANIA	
2	HASAN SHALA	FSH. QYSHK	
3	HAKI GASHI	FSH QYSHK	
4	FITIM KECINENDI	F.SH QYSHK	
5	FATMIR IMAMI	CEKIBO	
6	GRIGOROVIC	POC	
7	SEJFI ÇEKU	F.SH QYSHK	
8	JALON KABASHI	F. ZAHARA	
9	BURIM - II -	F. - II -	
10	DRITA KRASHI	K. Peja	
11	SHPRESA LUKA	K. PEJE	
12			
13			
14			
15			
16			
17			